REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIBER

Prot 23134 19/08/2016

# KONTRATE
## (SIPERMARRJE)

Nënshkruar në Bashkine Dibër

Sot me datë 18.08.2016

Ndërmjet palëve:

INVESTITORI: BASHKIA Dibër

Perfaqesuar: nga titullari: Z.Hatem Fida
Me cilesine e Autoritetit Kontraktor

SIPERMARRESI: "Alko Impex General Construction"sh.p.k

Përfaqësuar nga : Z. Arber ABAZI
Me cilesine e Kontraktorit

Emertimi i kontratës

**"Rinovim i infrastrukturës së bulevardit "Elez Isufi", rrugës "Safet Zhulali" dhe rrugës së "Muzeut"**

**Neni 1**
**Baza ligjore**

- Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik",i ndryshuar
- VKM Nr. 1, date, 10.01.2007 "Rregullat e Prokurim Publik",i ndryshuar
-Ligji 9936,datë 26.06.2008"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH."ndryshuar
- Ligji nr.7850,datë 29.07.1994 "Kodi Civil i R.Sh.",i ndryshuar, nenet 850-876 e vijues.ndryshuar
- Dokumentat Standarde Të Tenderit Për Kontratat e Puneve Civile KPK dhe KVK – 2016.
- Akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

**Neni 2**

**Mbikqyrësi**

Mbikqyrës:(Per punimet), Emëruar nga investitori .

**Neni 3**
**Objekti i Kontratës**

Objekt i kesaj kontrate eshte sipermarrja e punimeve te ndetimit me "Rinovim i **infrastrukturës së bulevardit "Elez Isufi", rrugës "Safet Zhulali" dhe rrugës së "Muzeut"**

**Neni 4**
**Vlera e Kontratës**

Kontrata lidhet me nje vlere totale 104 789 063 *(njëqind e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e tre)* me tvsh

**Neni 5**
**Afati i Kontratës**

Afati maksimal i perfundimit te punimeve eshte **75 ditë pune, nga data e lirimit të sheshit të ndërtimit**.

**Neni 6**
**Gjuha e Kontratës**

Gjuha e kontratës do të jetë gjuha ***shqipe.***

**Neni 7**
**Komunikimi**

*Çdo* komunikim në mes paleve do të jetë me shkrim

**Neni 8**
**Sigurimi i kontratës**

Sigurimi kontratës do jetë **10%** e vlerës së kontratës ose ne nje vlere totale prej 0 478 907dhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntë qind e shtatë ) lekë .

**Neni 9**
**Realizim i kontratës**

Realizimi i kontratës dhe i punimeve sipas projektit dhe preventivit të tenderuar.

**Neni 10**
**Detyrimet e investitorit**

...përmbushe të gjitha detyrimet sipas kontratës si me poshtë:

...oni nepërmes mbikqyresit (drejtori i punimeve) do të njoftojë sipërmarrësin ...kim lidhur me çdo difekt përpara mbarimit të periudhes së garancisë.

...ma e sigurimit të kontratës do të jetë *10%* të vleres së kontratës dhe do ti ...thehet kontraktorit jo më vone se 30 dite pas datës së marrjes në dorezim të punimeve.

3. Ndryshimet që do te bëhen nga palet në preventiv do të përballohen nga fondi rezerve i parashikuar në preventiv.
4. Mbikqyresi (drejtori i punimeve) do të kontrolloje punën e kryer nga sipermarresi brenda **20** diteve nga paraqitja e situacionit.
5. Mbikqyresi i punimeve, pasi bën verifikimin e përfundimit të punimeve, brenda **30** diteve i paraqet Entit situacionet e punimeve .
6. Pas kolaudimit të objektit dhe marrjes në dorëzim të tij Autoriteti kontraktore ben çlirimin e subjektit nga detyrimi i sigurimit të kontratës , jo me vonë se 30 dite nga data marrjes në dorëzim.
7. Në situacionin e fundit Autoriteti Kontraktore mban të palikujduar vleren **5%** të kontrates për efekt sigurie për riparim defektesh në **afat 24 Mujore** duke filluar nga data e aktit të kolaudimit e marrjes në dorëzim të punimeve .

## Neni 11
## Detyrimet e Sipërmarresit

Sipermarresi do të përmbushe të gjitha detyrimet e vena në kontrate si me poshtë:

1- Sipërmarresi do të përmbushe të gjitha detyrimet për sigurimet që rrjedhin nga ligjet në fuqi në Shqipëri dhe që lidhen me rreziqet që sipërmarresi duhet të përballoje nga data e fillimit të punimeve deri në përfundim të objektit dhe të periudhës garancisë.
   a) Dëmtimet e punimeve.
   b) Humbjet e dëmtimet e materialeve e paisjeve.
   c) Plagosjen ose vdekjen e përsonelit në punë.

3- Sipërmarresi do të kryeje punimet në perputhje me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike.

4- Sipërmarresi do të plotësoje programin sipas grafikut të parashikuar të punimeve.

5- Sipërmarresi përgjigjet për cilesinë e materialeve që perdoren në objekt, të cilat duhen të jenë në përputhje me kërkesat e kontratës, të çertifikuara apo me flete analize.

6- Sipërmarresi është përgjegjës për sigurimin teknik të të gjitha veprimtarive në kantierin e ndërtimit

7- Sipërmarresi do të korrigjojë të gjitha difektet brenda afatit të parashikuar nga (Mbikqyrësi).

8- Sipërmarresi do të mbulojë të gjithë koston e riparimit të difekteve.

Kjo kontratë nënshkruhet në 5 kopje, nga të cilat:
- Autoriteti Kontaktorë 3 (tre) kopje
- Kontraktori 2 (dy) kopje

*PER SA ME SIPER PALET*
RANE DAKORT DHE NENSHKRUAN

P A L E T

PER KONTRAKTUESIN
"Alko Impex General Construction"sh.p.k

Arber ABAZI

PER INVESTITORIN
Bashkia Diber

Hatem Fida